



Në bazë të nenit 47 paragrafit 1 pikës 6 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83 /18) dhe nenit 114 paragrafit 2 të Ligjit për bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19 dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e

Vendimit për mënyrën e kryerjes së supervizionit dhe mbikëqyrjes ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 250/19)

1. Në vendimin për mënyrën e kryerjes së supervizionit dhe mbikëqyrjes ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 58/18), pas pikës 13, shtohet një pikë e re 13-a, e cila thotë:

"13-a. Me përjashtim të pikës 10 të këtij vendimi, në rastet kur Guvernatori i Bankës Popullore ka ndërmarrë ose do të ndërmarrë masa të rregullta ose shtesë për arritjen dhe ruajtjen e një sasi më të madhe të mjeteve të veta dhe/ose një normë më të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit, në përputhje me nenet 132 dhe 133 të Ligjit për bankat, bazuar në profilin e përgjithshëm të rrezikut të përcaktuar të bankës, personat e autorizuar përgatisin plan të aktiviteteve të supervizionit për bankën, nëse është e nevojshme i propozojnë bankës masa të tjera dhe të paktën një herë në vit e rivlerësojnë nevojën për të arritur dhe mbajtur një sasi më të lartë të mjeteve të veta dhe/ose normë më të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Gjatë rivlerësimit nga paragrafi 1 i kësaj pike, merren parasysh edhe rreziqet e pranishme në operacionet e bankës, që mund të kenë ndikim në ruajtjen ose prishjen e sigurisë dhe stabilitetit të sistemit bankar në tërësi dhe rezultatet e stres-testeve të kryera nga banka dhe/ose Banka Popullore, duke e marrë parasysh modelin e biznesit të bankës.

Në rastet nga paragrafi 1 i kësaj pike nuk zbatohen dispozitat e pikave 11, 12 dhe 13 të këtij vendimi".

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

V. nr. 02-15/XII-2/2019
29 nëntor 2019
Shkup

Guvernator
dhe kryesues
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
dr. Anita Angelovska-Bezhoska